


## Kulturë




Më 1942, miqësia e tij me Pikason i dha fund këtij momenti intim dhe përgjatë disa viteve ua dedikoi punën e tij rrymave tradicionale të pikturës: natyrave të qeta, peizazheve dhe portreteve, në një udhëtim që e çoi deri tek abstraksionet. Në 1954, Clavé, i cili tashmë ishte një figurë artistike e rëndësishme në një univers plastik të Francës dhe pasi jetoi një periudhë suksesesh të mëdha skenografike ndërkombëtare, vendosi t'i dedikojë krejtësisht pikturës

## Clavé, intim deri në fund të miqësisë me Pikason

Rreth 44 vepra të krijuara nga Antoni Clavé janë seleksionuar nga koleksione private posaçërisht për ekspozitën e çelur mbrëmë në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Ekspozita është quajtur "Antoni Clavé, një botë arti 1934-2002", me të cilin Shoqëria Shetërore për Veprimin Kulturor të Jashtëm të Spanjës (SEACEX), Ministria Spanjolle të Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Galerinë e Arteve dhe ambasadën e Spanjës - prezantojnë një nga krenaritë e kulturës moderne spanjolle në këtë vjeshtë festive për to. Ekspozita përfshin kolazhe, postera kinematografikë, skenografi teatrale dhe piktura, e të gjitha ato shprehin krijimtarinë e gjerë të artistit.

Antoni Clavé është një nga pionierët më të famshëm të modernizmit spanjoll me prezencën dhe famën më të madhe ndërkombëtare. Lindi në Barcelonë në 1913 dhe vdiq në Saint-Tropez në 2005. Në qytetin e tij të lindjes ai zhvilloi formimin e tij artistik, në kryqëzimet brilante që karakterizuan fundin e modernizmit. Fillimet e tij si vizatues në publikimet periodike qenë të shkëlqyera dhe shumë shpejt u kthye në një dizenjator të talentuar të posterave kinematografikë. Këta postera shfaqin një sinkretizëm plastik të kujdesshëm, qartësisht të influencuara nga burimet e avangardës që shënuan shekullin XX:



që nga kubizmi deri tek futurizmi, nga ekspresionizmi deri tek estetika e dizenjimit grafik. Clavé, i prekur nga Lufta Civile, u largua në Francë, ku zbuloi litografinë dhe gravurat, fusha të cilat më vonë do t'i hapnin portat e botës editoriale dhe që do ta bënin një ilustrues të njohur. Publikimet e tij si Carmen de Merimée (1946) apo Dama Maç e Pushkinit janë shembuj të këtij momenti. Përfaqësoi Spanjën në Bienalen e Venecias me një ekspozitë individuale.

Më 1942, miqësia e tij me Pikason i dha fund këtij momenti intim dhe përgjatë disa viteve ua dedikoi punën e tij rrymave tradicionale të pikturës: natyrave të qeta, peizazheve dhe portreteve, në një udhëtim që e çoi deri tek abstraksionet. Në 1954, Clavé, i cili tashmë ishte një figurë artistike e rëndësishme në një univers plastik të Francës dhe pasi jetoi një periudhë suksesesh të mëdha skenografike ndërkombëtare (Shtëpia e Bernarda Albës, Frika, Zija në 24 orë si dhe

bashkëpunimet me fat me Ruth Page për Operan e Çikagos), vendosi t'i dedikojë krejtësisht pikturës. Në këtë moment futi në krijimtarinë e tij një ikonografi mesjetare plasticiteti bindës: mbretër me mjekra, mbretëresha të pakapshme si dhe figura antropomorfe me një kuptim të fuqishëm. Kjo që gjithashtu një periudhë zbulimi dhe rikuperimi i materialeve plastike. Clavé u kthye në një ekspert të thurjeve, pigmenteve dhe derivateve të tyre vizuale, të cilët në funksion të dritës transformoheshin në një atmosferë ajrore, gjithnjë në një kundërshti formale me ritmet e pikturës.

Në 1956, Antoni Clavé zbuloi apo më mirë të themi i dha prioritet skulpturës, teknikë që e perceptoi në fillimet e viteve '30, me anë të një sekuence të mrekullueshme të objekteve të gjalla me një pamje surrealistike (Njeriu me monokël, Telefoni etj.). Pa dyshim kërcimi nga asemblimi deri tek kolazhi nënkuptoi një fokusim pikturues të ndërgjegjshëm që shkon më tej sesa korigjimi i lehtë teknik. Kolazhet e Clavésë gjithmonë i përgjigjen një skeme strikte shprehëse, duke e afruar veprën e tij me formalizmin. Aktualisht, kjo konsiderohet si periudha e shkëlqimit më të madh të Clavésë.

Ekspozita e mbrëmshme, që u hap në një ceremoni zyrtare, me të ftuar politikanë e personalitete të kulturës, do të qëndrojë e hapur deri më 15 dhjetor.

Përgatiti: V. Murati

## Elina Duni, "do marr çiftin" në jazz... shokuuese

Është e paimaginueshme që një këngë rakie, me shqiptarë të dehur, të kthehet në jazz. Këngën e famshme e të njohur folk, "Do marr çiftin do dal për gjuhë..." Elina Duni, që po mahnit botën e jazzit në Evropë, e sjell në Shqipëri, por veshur me një petk tjetër. Këngëve tona të folkut, të kënduara në dasma, në qejfe, në skuta shpirtërore e tavolina gëzimesh, puro etnos shqiptar, Elina u ka dhënë frymëzime jazzi. Sigurisht, mbrëmja e prodhuar ka qenë fantastike dhe në dy këngët e fundit publiku ka "ulëritur" që mbrëmja e Elinës të mos mbaronte aq shpejt. Rreth 1 orë koncert, shumë pak për ta shuar etjen e publikut shqiptar me një nga zërat që po pushton Evropën e jazzit. Tjetër këngë që u mori frymën të pranishmëve, ishte një këngë që, siç tha Elina, "ia kishte mësuar gjyshja kur ishte e vogël". Ajo e kishte marrë këngën, i kishte veshur një kostum jazz dhe përfundimi ishte një tërmet duartrokitjesh që shkundi nga themelet zemrën e vajzës shqiptare dhe të



gjyshes së saj, e cila ishte në sallë dhe e këndonte këngën nën zë së bashku me mbesën e saj, e cila i iku e vogël dhe iu kthye e madhe në të gjitha kuptimet e mundshme: moshë, sukses, prestigji dhe e ardhme e ndritur.

Asgjë, madje as mungesa e dritave që shtyu koncertin për rreth 1 orë, nuk mund ta zbehte sadopak shkëlqimin mbresëlënës të këngëtares shqiptare Elina Duni. Koncerti u zhvillua dje në sallën e madhe të Akademisë së Arteve dhe zgjati afro një orë, gjatë së cilës këngëtarja virtuozë shpalosi vetëm një pjesë të vogël të asaj që ka vite që po bën në skenat më prestigjioze të Evropës. Së bashku me bandën e saj ajo

"tregoi një përrallë të bukur kombëtare" në gjuhën e jazzit. Elina dhe Colin Vallon (piano), Patrice Moret (bass) dhe Norbert Pfammater (bateri) dhanë një performancë të një folklori shqiptar që kalëronte hijshëm në pentagramet ndërkombëtarë të jazzit. Kjo u prit jashtëzakonisht ngrohtë nga spektatorët, të cilëve po u shijonte aq shumë vajza shqiptare që gëzojnë një reputacion të jashtëzakonshëm në jazzin evropian dhe jo vetëm. Elina është vajza e regjisorit Spiro Duni dhe e aktore dhe shkrimtares Besa Myftiu. Me sa duket, vajza e vogël e artistëve ka marrë më të mirën e të dy prindërve të saj dhe dje na dhuroi një marramendje aq të hijshme. Përkundrazi, atë që u mungon skenave shqiptare. Fatkeqësisht, talentet e tilla ne nuk mund t'i mbajmë, sepse nuk u ofrojmë dot asgjë... madje as elektricitet për të dhënë një koncert, kështu që duhet të kënaqemi vetëm kur ata vetë kujtohen të vijnë e të flasin shqip.

Albano Bogdo

d.m.th., latinët, me dhuntitë e tyre për ekulibër, të zellit metodik për punën, të lidhjes me tokën, si kundërpeshë ndaj prijevës shpërbërëse, qendërkëse, spekuluese... Ky arumun është një element i lënë përgjithësisht pas dore nga biografët e Shqipërisë, por mbi të cilin me të drejtë Baldaci tërheq vëmendjen në librin e tij klasik "L'Albania" - Shqipëria, që mbetet më i ploti dhe objektivi mes gjithë atyre, në çfarëdo lloj gjuhe, që janë shkruar për këtë çështje për Shqipërinë. Këtu, në Shqipëri, këta arumunë përbëjnë një pakicë, një pakicë të qetë dhe punëdashëse, që marrin pjesë aktivisht në jetën e vendit. Por kjo pakicë nuk është veçse gjymtyra e cinguar e një njësie etnie në Pind. Janë popullsi rumune, ajo çfarë ka mbetur nga Vllahia e Madhe, të pastra nga ana racore, nga ana kulturore. Iu kundërvunë dhunës turke dhe, duke derdhur gjak, mbetën të pavarur, popullsi rumune, pra, romane, pra, me ndjenjën e së drejtës dhe të shtetit, të rrënjësor në ndërgjegje, me dashurinë kryeneçe për tokën dhe punën. Që janë dhe që ndihen romanë. Nga të gjithë ata që jetojnë në Shqipëri kanë qenë më fatlumët: në fakt, ata

kanë katër shkolla dhe shtatë kisha, sepse në të gjithë Ballkanin, shqiptarët janë, pa asnjë dyshim, më të afërtit me këtë botë latine dhe më humanët". Valentin Mustaka citon edhe autorë të tjerë, si: Nikolla Jorga, Edvin Jacques, Serge Metais, Oliver Jens Schmitt, William Martin Leake, Milan Shufllaj, Zef Mirdita, Mathieu Aref, Nicholas Hommond, Dhori Fallo, Sami Frashëri, Fatos Lubonja, C. Burileanu etj. Më përpara, Valentin Mustaka ka botuar mjaft artikuj dhe libra, si veprën studimore me dy vëllime "Nëpër labirintet e historisë së arumunëve". Siç e vlerësoi edhe kritiku Perikli Jorgoni, "nga studimi i vëmendshëm i gjithë veprës publicistike e studimeve të Valentin Mustakës, arrijmë në përfundimin se kemi të bëjmë me një hulumtonjë me kërkesa shkencore, me një studionjë që çështjet që parashtron i mbështet në fakte e dokumente historike, në një hulumtim të gjatë nëpër trevat ku janë përqendruar arumunët, me njohjen e plotë të historisë, folklorit, gjuhës, etnografisë e thesarit folklorik të tyre dhe, mbi të gjitha, të literaturës vendase dhe të huaj mbi këtë argument".